



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 109/13
Prishtinë, më 24.05.2013, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Duda Balje Sevdije Lama, Hykmete Bajrami, Hasime Krasniqi, Naser Osmani, Latif Gashi, Sali Asllanaj, dhe Albana Fetoshi.

Mungoi: Xhevdet Neziraj.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli, Imba Rudaku (praktikante) dhe Arbëreshë Kosumi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Florian Dushi, Erkan Spat, Miradije Meha, dhe Enis Halimi nga KQZ-ja, Ahmet Krasniqi, Avdyl Krasniqi dhe Shehrije Saliuku nga AKK-ja dhe Ramadan Islami, Rejhane Zylfijaj nga GIZ.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit dt. 17.05.2013;**
3. **Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2012;**
4. **Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2012;**
5. **Shqyrtimi i Propozimit të Panelit Vlerësues të Bankës Qendrore për plotësimin e një pozite për anëtar joekzekutiv të Bordit të BQK-së;**
6. **Shqyrtimi i Raportit tremujor të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2013;**
7. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit dt. 17.05.2013

Kryetarja konstatoi se procesverbali miratohet njëzëri .

3. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2012

Kryetarja theksoi se raporti financiar i KQZ-së përmban të dhëna të detalizuara, ku 49.06% e buxheti është e shpenzuar , nga raporti shohim se është një arsyeshmëri e shpenzimit të tillë të buxhetit pasi që KQZ-ja për vitin 2012 ka parashikuar që të mbahen zgjedhjet për President të Kosovës, prandaj edhe kanë mbetur mjetet e planifikuara. Në Ferizaj dhe në Kaçanik janë mbajtur zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe një pjesë e buxhetit është shfrytëzuar për këto zgjedhje.

Florian Dushi prezentoj raportin vjetor financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike, ku janë të paraqitura edhe në raportin me shkrim. Arsyeshmëria pse nuk janë shpenzuar mjetet në nivelin e ultë të kategoria ekonomike mallra dhe shërbime është pasi që nuk janë mbajtur zgjedhjet për President të Kosovës.

Kryetarja kërkesa për të rritur numrin e të punësuarve është një dukuri që po haset tek shumica e institucioneve, po në anën tjetër këto vende nuk plotësohen. Pas kërkesës së KQZ-së për të rritur numrin e të punësuarve janë aprovuar tri pozita po në anën tjetër shohim se tri pozita janë të paplotësuar. Ndërsa buxheti për paga dhe mëditje është shpenzuar 98%, është një dukuri e keqe që këtë vit është vërejtur , nuk i plotësojnë numrin e të punësuarve të paraparë dhe mjetet që mbeten i shpërndajnë tek bordi apo tek të punuarit e tjerë.

Florian Dushi janë pozitat e Kryeshefit dhe zv. Kryeshefit dhe Zyrtarit për Komunën në Veri e cila edhe sot vazhdon të jetë e paplotësuar sepse jemi në pritje. Ndërsa sa i përket pozitës së Kryeshefit dhe zv. Kryeshefit kemi pasur një problem edhe pse është shpallur në fund të vitit për shkak se nuk ka pasur procedurë nga zgjedhja e fundit e kryeshefit dhe jemi vonuar në përgatitjen e një akti nënligjor që e parasheh procedurat në detaje të zgjedhjet të kryeshefit. Sot i kemi të plotësuar pozitën e kryeshefit dhe zv. kryeshefit .

Latif Gashi buxheti për Paga dhe Mëditje është shpenzuar 98% e njerëzit nuk kanë punuar , a ka qenë i planifikuar buxheti për këta punëtor apo është shpërndar buxheti për punëtorët ekzistues?

Miradije Meha gjatë vitit të kaluar ne kemi pas dy parë zgjedhje të jashtëzakonshme në komunën e Ferizajit dhe Kaçanikut dhe kemi pasur orarin e zgjatur të punës, kemi orë shtesë dhe për atë periudhë ne i paguajmë zyrtarët që angazhohen. Gjatë kësaj periudhe janë paguar me orar shtesë edhe 43 punëtor tjerë, dhe kjo ka ndikuar që të shfrytëzohet buxheti në këtë masë.

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratoj raportin financiar vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2012.

4. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2012

Kryetarja ne kemi marrë raportin vjetor të AKK-së, por kemi marrë edhe raportin financiar ,është vërejtur se buxheti është shpenzuar 78.66%. Për më tepër sqarime është ftuar ushtëruesi i detyrës së Kryetarit.

Ahmet Krasniqi prezentoj raportin vjetor financiar të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike, ku janë të paraqitura edhe në raportin me shkrim.

Hykmete Bajrami tek rasti i Sharrcemit jeni në procedurë ose keni shqiptuar një dënim për krejt atë që ka ndodhur në vitin e kaluar, a mund të na informoni në lidhje me rastin?

Ahmet Krasniqi rasti i Sharrcemit është që nga viti i kaluar në procedurë të hetimeve mbledhjes së të dhënave, ju e dini se Ministresha në vitin e kaluar e ka marrë një masë mbrojtëse të prodhimeve vendore. Ne e kemi konstatuar edhe atëherë që masën që e ka marrë ose vendimin nuk është punë e jona. Mirëpo nuk ka dhënë të drejtë ai vendim që Sharrcemi të keqpërdor pozitën që e ka pasur dhe që e ka. Kemi konstatuar që e ka pas pozitën dominuese dhe e ka. Neve na është dashur të konstatojmë se a ka pasur apo jo çrregullim në treg. Do të thotë janë plotësuar kushtet që ne të marrin një vendim qoftë sanksionues, qoftë lirues dhe shumë shpejtë do ta marrim atë vendimin për Sharrcemin.

Naser Osmani disa veprimtari biznesore të njerëzve që kanë përfituar të drejtën prej Qeverisë apo prej Ligjeve të Kosovës me ushtruar atë veprimtari të biznesit që kanë monopol njëqind-përqind, a keni ndonjë evidencë dhe çfarë jeni duke bërë që të ndryshohet kjo gjendje?

Ahmet Krasniqi Ligji ynë nuk e ndalon që qenurit monopol një ndërmarrje, e ndalon keqpërdorimin e atë monopol. Agjencia gjithmonë bën monitorim nëse ka ngritje- ulje të çmimeve të padrejta. Rekomandimet tona janë që qoftë licencat që bëhen nga Ministrit e ndryshme ose nga Qeveria ose lejet që i marrin të ketë më shumë operator në treg për t'u zhvilluar një konkurrencë e drejtë dhe reale. Paraqiten edhe rastet kur ka më shumë të licencuar dhe bëhet marrëveshje mes veti që të fiksojnë çmimet. E kemi rekomanduar Ministrinë e Infrastrukturë, ka qenë një udhëzim për ndarje të tregut, nuk kanë pasur të drejtë të bëjnë kontrolla teknike të automjeteve pasi që ka qenë në kundërshtim me ligjin tonë.

Naser Osmani sqaroj se nuk është fjala për çmimet e konkurrencës por për shërbimet që ofrojnë. Ju theksuat çështjen e laboratorëve për cilësinë e derivateve ka edhe monopole të tjera. Mendoj se kjo dukuri duhet të rregullohet, çështja e çmimeve është provuar edhe me çmimet e naftës, pavarësisht mospërfundimit janë përfitimet e interesave biznesore. Në bazë të një vendimi të një ministri apo të një ligji që e amnistion një kompani private është një shërbim që në fakt është monopol.

Ahmet Krasniqi theksoj se veprimtaritë ekonomike janë mallrat dhe shërbime, vlen të theksohet rasti me arka fiskale ku janë dënuar dy operatorë në shumat 100.000€. Gjithashtu edhe kompanitë e sigurimit janë të dënuara në po të njejtën shumë. Në shumë raste vendimet qeveritare që merren për licencime e dërgojnë një ndërmarrje në pozitë dominuese, ne rekomandojmë që të ketë konkurente më shumë. Nëse nuk e plotësojnë kushtin mundohemi që me atë kapacitetin që e posedojmë të bëjmë kontrollimin në mënyrë që mos të bëhet abuzim me atë pozitë.

Latif Gashi konstatoi se janë bërë disa rekomandime nga disa institucione, disa nga të cilat janë të pranuar, më intereson të kuptoj se cili është roli juaj ndaj institucioneve që nuk i kanë pranuar rekomandimet e juaja. A jeni institucion që vetëm jep rekomandime apo edhe mund të nxjerr vendime?

Ahmet Krasniqi sqaroj se institucioneve shtetërore mund ti japin vetëm rekomandime ndërsa puna jonë lidhet me ndërmarrje. Vendimet e institucioneve autorizimet që i bëjnë nuk i japin të drejtë një ndërmarrje që të sillat ashtu si të dëshiron sepse ne jemi të detyruar për të kontrolluar.

Hykmete Bajrami konsideroj se AKK-ja jep vetëm rekomandime për institucionet shtetërore, psh Ministria e Tregtisë ka thënë se laborator i naftës si ka plotësuar kushtet duke e ditur që në fillim ka qenë një kompani vendore që ka pasur laboratorin e naftës, i ka marrë asaj licencën dhe i ka dhënë një kompanie të huaj. Nuk dihen tentativat e kësaj ministrie sepse është një biznes profitabil, arsyetimi se

asnjë kompani nuk i plotëson kushtet për të hapur laborator për cilësinë e naftës duket i pajustificueshëm. U përmend edhe rasti i distribucionit dhe furnizimit të energjisë duke i dhënë leje për monopol nga ai publik në privat por e gjithë puna do të jetë në kontrollin e çmimeve.

Ahmet Krasniqi sqaroi se sipas ligjit të ri për mbrojtjen e konkurrencës, dënimi maksimal që mund ti shkarkohet një kompanie është 10 % e të hyrave të vitit paraprak të asaj kompania.

Latif Gashi kërkoi sqarim se a ka raste kur është treguar edhe masa e shqiptimit të gjobës?

Ahmet Krasniqi sqaroi për laborator të naftës kemi njohuri për ankesat të cilat kanë ardhur, janë shqyrtuar edhe gjatë bisedës me ministreshën është thënë se nuk i plotëson kushtet. Jemi munduar të kuptojmë se a egziston konflikt interesi kemi kaluar tek çmimet, duke pyetur Shqipërinë, Kroacinë, Maqedoninë. Tek të gjitha këto shtete nuk është komision privat por janë operator shtetëror. Meqenëse ata janë prodhues të naftës dhe duhet të kenë operatorin i cili e kontrollon cilësinë e naftës vetëm në nivel shtetëror. Sa i përket entit për energji, nuk mund të thirremi në atë se Kosova keqpërdor monopolin sepse i ka çmimet më të larta apo më të ulëta. Kurse çështja e lejes nuk është e drejtë të mos iu ipet nëse i ka plotësuar kushtet, ajo është çështje e privatizimit, marrja e kontrollit nga një ndërmarrje në një ndërmarrje tjetër është e lejuar nëse nuk ka për qëllim të fuqizimit apo krijimit të pozitës dominuese të re. Gjyba për vitet paraprake janë shqiptuar për dhjetë kompani të sigurimeve dhe dy kompani të arkave fiskale. Vitin e kaluar kemi pas disa vendime që në një mënyrë nuk janë gjobitur, sepse kanë pranuar fajin. Nëse shohim se kemi ne shoqëri egziston nuk i lirojme nga dënimet.

Kryetaria kërkoi përgjigje për pesë punëtorët të cilët kanë qenë të planifikuar për ndihmë shtetërore edhe gjatë vitit të kaluar por nuk janë të punësuar.

Ahmet Krasniqi sqaroi se edhe në raportin që kemi bërë në Bruksel e na është dhënë një vërejtje se deri kur mundemi me kthi, deri tani arsyeja e vetme është mungesa e hapësirës. Kemi shikuar një vend por të gjitha shpenzimet e komunalive, sigurimit, qirasë kemi parë se ato mjete nuk mjaftojnë. Jemi në procedurë të rekrutimit dhe shumë shpejt do të formohet një zyrë.

Sali Asllanaj kërkoi sqarim lidhur me atë se a janë dënimet eventuale adekuate krahas ndonjë kompanie e cila ka përfitime të mëdha.

Ahmet Krasniqi sqaroi se me ligjin e vjetër ka qenë dënimi maksimal 100.000 € kurse ligji i ri 10% të të hyrave të një viti paraprak. Vendimet tona nuk janë ekzekutuese nëse pala paraqet padi për konfliktin administrativ.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë:

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë raportin financiar vjetor të Autoritetit Kosovë i Konkurrencës për vitin 2012.

5. Shqyrtimi i Propozimit të Panelit Vlerësues të Bankës Qendrore për plotësimin e një pozite për anëtar joekzekutiv të Bordit të BQK-së

Kryetaria theksoi se është një propozim i panelit seleksionues për të cilin kryesia e Kuvendit na ka ngarkuar ta shqyrtojmë lidhur me plotësimin e një pozite për anëtar joekzekutiv të Bordit të BQK-së.

Gjatë analizimit të materialit shohim se janë respektuar procedurat ligjore dhe kandidatët përmbushin kushtet ligjore.

Hykmete Bajrami mendoj se ne si komision shqyrtojmë vetëm se a i kanë plotësuar kushtet e kërkuara dhe nuk i kemi rekomanduar asnjëherë Kuvendit për një person të caktuar, dje në media Agjencioni Kundër Korrupsionit ka deklaruar se kandidati Sejdi Rexhepi, është në konflikt interesi për shkak të mbajtjes së dy pozitave në Universitet të Prishtinës dhe në bordin e BQK-së.

Kryetarja theksoj se tek neni 40 pika 4 shkruan: Përgjashtimisht nga paragrafi 3 i këtij neni një zyrtar apo punëtor i Universiteti apo ndonjë organizate apo ndonjë institucioni që ka pavarësi operationale nga Qeveria nuk do të konsiderohet të jetë zyrtar apo punëtor i Qeverisë apo i një Ministrie.

Latif Gashi kostatoj se nuk mund të ndikohemi nga media pasi që jemi të informuar sesi ato funksionojnë sot, mendimet e individëve nuk janë shumë të rëndësishme, duke pas parasysh edhe shumë reagime të partisë tonë për individë të caktuar pra jam i pajtimit që të dërgohet kandidati i parë.

Naser Osmani konsideroj se nuk është çështje mediale është çështja e agjencionit antikorruption, institucion i Kuvendit të Kosovës, nëse një person është i përfolur për konflikte të interesit, duhet të jetë shumë i fuqishëm pra mendoj se personi në fjalë nuk e meriton të jetë aty duke pas parasysh personi i cili ka qenë më parë në atë pozitë.

Kryetarja sqaroj se edhe kandidati i dytë është prodekan por edhe profesor, duke u nisur nga pika e 4 e ligjit propozoj që të rekomandojm në Kuvend që të tre kandidatët.

Latif Gashi pajtohem që të rekomandohen të tre anëtarët pasi që shihet se Komisioni ka qenë mjaft profesional në vlerësim. Përgjegjësi e tyre mbetet nëse na kanë rekomanduar dikë që është konflikt me nenin paraprak. Janë organet e tjera që bëjnë lejimin apo kontestimin.

Pas diskutimeve, Komisioni me gjashtë vota për (Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Duda Balje, Sevdije Lama, Hasime Krasniqi, Latif Gashi) dy vota kundër (Naser Osmani, Hykmete Bajrami) dhe një abstenim (Albana Fetoshi), Komisioni nxorri këtë :

Rekomandim

1. I rekomandon Kuvendit, të përzgjedhë njërin prej kandidatëve për pozitën e anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, me votim të fshehtë, si në vijim:

Sejdi Rexhepi,
Arben Dërmaku,
Driton Balaj.

2. Kandidati i përzgjedhur nga Kuvendi, t'i dërgohet Presidentes për miratim dhe emërim në pozitën e anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

6. Shqyrtimi i Raportit tremujor të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2013

Ismet Krasniqi theksoj se sipas obligimeve që dalin nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike kemi përgatit raportin e shpenzimeve të tre mujorit të parë për vitin 2013, dhe sipas të dhënave dhe

menaxhimit të shpenzimeve janë prezantuar të gjitha pozicionet që janë shpenzuar gjatë këtij tre mujori. Është një vërejtje tek shkalla e përqindjes, tek kategoria *Paga dhe Mëditje* shpenzimet nuk janë kalkuluar për muajin Mars kanë mbetur për raportin në vijim.

Naser Osmani mendoj se duhet të rregullohet çështja e Wifi-së.

Latif Gashi pyet pse janë shpenzuar kaq pak mjete për këtë tremujor?

Ismet Krasniqi sqaroj se shpenzimet kapitale për këtë tremujor janë 21% që do të thotë se kur të pjesëtohet për katër periudha të vitit ku totali në fund do të jetë 95%. Për këtë periudhë duhet të kemi parasysh se Ligji për Prokurimin, i cili parasheh procedurat e veçanta. Punë efikase është bërë vetëm gjatë muajit Mars. Poashtu çështja e wirleesit është një problem teknik, jemi duke punuar rreth filtrave të ndryshëm që të ketë adresa vetëm për deputetë të cilët do ta kenë qasjen e duhur por e gjithë kjo kërkon disa paisje shtesë.

Kryetarja vlerësoj se në njësinë për mbikëqyrjen e institucioneve të pavarura shihet se është një i punësuar, kurse kur është miratuar numri i të punësuarve tre kandidatë kanë qenë për formimin e kësaj njësie, duke bërë kështu mbikëqyrjen më të mirë të institucioneve.

Ismet Krasniqi sqaroj se në kuadër të zyrës së sekretarit kanë qenë të fokusuar tri pozicione, njëri ka qenë zyrtar ndërlidhës me agjencionet e pavarura, njëri pozitë ndërlidhëse me donatorët e jashtëm dhe shoqërinë civile, si dhe zyrtari ndërlidhës me Parlamentin Evropian. Nga këto tre pozita është plotësuar vetëm pozita e zyrtarit ndërlidhës me agjencionet e pavarura- detyrë e të cilit është të ketë kontakte me agjencionet e pavarura të Kuvendit, shkëmbim të informacioneve, një qasje më e lehtë për aktivitetet që zhvillohen në agjencione. Jemi në situatë më të palakmueshme sepse kemi filluar kopjimin e praktikave të vendeve të rajonit ku formojnë njësi për agjencionet ndërlidhëse. Në të njëjtën kohë kemi edhe komisionet nga fusha respektive që e përcjell agjencionin. Ekziston një lloj dualizmi. Me një zyrtar është bërë përpjekje të bëhet një data bazë të të dhënave për agjencionet e pavarura por për punët që do të rrjedhin gjatë mandatit të tij është e pamundur që të përfshihen të gjitha aktivitetet e agjencionit të pavarur. Presim që numri i agjencioneve të zvogëlohet në të ardhmen.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë:

Rekomandim

I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të miratojë Raportin tremujor të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2013.

7. Të ndryshme

Përqatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesja e Komisionit

Safete HADERGJONAJ